

DPK/DMP

03-1452/13

02

21.05-2013

Regj.nr.10118/12

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN,Departamenti I pergjithshem-Divizioni I kundervajtjes,sipas Gjykatesit Veli Kryeziu,kunder te pandehurit Tahir Arifi nga Gjilani,Rruga Arben Ramadani ,Lagja Arberi p.n.per shkak te kundervajtjes nga neni 17 p.1.3,te Ligjit nr.04/L-50 te Ligjit per deklarim,Prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te zyrtarve te lart public,e ne baze te nenit 73,74,195 dhe 9 te Ligjit mbi kundervajtjet,me date 29.04.2013 muar kete :

A K T V E N D I M

I pandehuri **Tahir Arifi** nga I ati Xheladin I lindur me 12.08.1972 ne Lip[ovice tani me vendbanim ne Gjilan,Rruga Arben Ramadani pn.,shqiptar ,shtetas I Republikes se Kosoves,me profesion punetor ne Arsim I martuar,I gjendjes se mesme ekonomike,kinse nuk eshte I denuar e as ne hetime

Ë S H T Ë P E R G J E G J Ë S

Sepse me date 03.07.2012 eshte konstatuar se I njeiti me kohe nuk e deklaruar formularin mbi deklarimin e pasurise si zyrtar I lart per deklarimin e pasurise,sepse si keshilltar I KK Gjilan,pas afatit ligjor e ka derguar te njejtin.

Me qka ka kryer veper kundervajtese nga neni 17.al.1.3,Per deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurise dhe te zyrtarve te larte Publik.,dhe per ate sh:pallet pergjegjes dhe

D E N O H E T

ME DENIM ME GJOBË ne Shumen prej 500 (Pesqid euro),te cilen gjobe I pandehuri eshte I obliguar ta paguaj ne afate prej 15 ditesh nga dita e plotefuqishmerise se ketij Aktvendimi ne te kunderten,gjoba do te zavendsohet ne denim burgu kun je dite burgu ka per tiu llogaritur 20 euro. Obligohet I pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqësor të paguaj prej 10 euro,ne afatin e njejtë si dënimi me gjobë.

A r s y e t i m

Agjensioni kundër kurupsionit me kerkesen e vetë nr. 01-2358/12 te datës 18,07,2012 ka kerkuar qe kunder te pandehurit te zhvillohet procedura dhe të ndeshkohet sipas Ligjit.

Gjzkatësi i diviyionit te kundervajtjes duke u bazuar ne Ligj,thirri te pandehurin i cili me date 23,04,2013 u deklarua ne lidhje me vepren kundervajtese e i cili ne deklaraten e vete nder të tjera ka theksuar ËE ndiej veten fajtor dhe kerkoj nga Gjykata qe te me shqiptoj nje dënim sa ma të but,ketë vit deklarimin e pasurise e kam bere me kohe dhe mbesë me shpresë që së paku nga ana e kesaj gjykate të miren parasysh thenjet pasi jam punetor arsimi dhe se dënim do te ndikoj negativisht te une.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar ne tersi kundërvajtjen e bërë,gjykatësi nuk pati nevoj të shtjelloj prova tjera,andej e shpalli përgjëgjës për vepren kundërvajtëse dhe i shqipto nje denim sa ma të butë,si në


-2-

dispozitiv të këtij Aktvendimi dhe ate duke u bazuar ne nenin 17,p1,3 të Ligjit Per deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurise dhe te zyrtarve te larte Publik.

Me rastin e matjes së së dënimit me gjobë,gjykata me kujdesë vlersoi mbrojtjen e të pandehurit si dhe shkresat e lëndës duke u bazuar ne rethanat lehtësuese dhe renduese në lidhje me veprën kundërvajtëse në fjalë.Andej duke e zbatuar nenin 9 të LMK-së Gjykatësi zbuti jashtezakonisht denim e parapar ligjor ,duke mar parasysh se ky është denim I pare dhe se ne të ardhmen është deklaruar se nuk do të kryej veper tjeter të llojit të njejt,është punëtor arsimor,dhe se nuk do të përsrisë kundërvajtjen e tillë,kurse si rethan renduese u muar pasha e kundërvajtjes dhe I shqiptoi kete denim,I bindur se edhe me kete denim ka për tu arritë qëllimi I dënimit tek I pandehuri,Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar në bazë të nenit 109 par.1 të Ligjit mbi kundervajtjet,
Me sa u tha me lartë u vendosë sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DIV.KUNDËRVAJTJES
ME 24,04,2013

Gjyqëtar
Veli KRYEZIU



UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIKË :Kundër këtij Aktvendimi eshte e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë ,Divizionit për kundërvajtje,ankesa dorëzohet perms këtoj Divizioni.